



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË PRONAVE

Nr. 2569/Prot.
2

Fier, më 27.02.2026

Projekt - Vendim

Nr. 26 datë 27.02.2026

“Për miratimin e formalizimit të marrëdhënies juridike për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier, të objektit “Qendra Shëndetësore Nr.3” me nr. pasurie nr. 12/397 zk. 8532, me sipërfaqje 820 m², e ndodhur në lagjen “Liri Gero” Fier, pronë e Bashkisë Fier”

Në bazë të nenit 9 pika 1.2 shkronja “a dhe c”, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 901 e vijues të K.Civil të R.Sh, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 574 dt. 28.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier Qarku Fier”, kërkesës nr. 235 prot. dt. 25.02.2026 të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier e protokolluar me nr. 2569 prot. dt. 25.02.2026, **Kryetari i Bashkisë;**

PROPOZON

1. Miratimin e formalizimit të marrëdhënies juridike për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier, të objektit “Qendra Shëndetësore nr. 3” me nr. pasurie nr. 12/397 zk. 8532, me sipërfaqje 820 m², e ndodhur në lagjen “Liri Gero” Fier, pronë e Bashkisë Fier.
2. Autorizohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e procedurave të mëtejshme administrativo - ligjore.

Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Pronave
Konc. M. Petushi

Drejtoria Juridike
Drejtoreshë: E. Kapllanaj

KRYETARI

Armando SUBASHI

